



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Adresa: Rruga "Abdi Toptani", ish - hotel "Drini", Tiranë

Tel: 04 2268141; Fax: 042268142

Nr. 65/9 Prot.

Tiranë, më 06.04.2017

V E N D I M

Nr. 74, datë 06.04.2017

***“Mbi përfundimin e procedimit administrativ,
filluar me urdhrin e verifikimit nr. 65/1 prot, datë 22.02.2017”***

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Inspektimit dhe Hetimit Administrativ, në lidhje me procedurën e verifikimit të kryer në institucionin e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, për rastin e nëpunëses *****,

VËREJ SE,

Me Urdhrin nr. 65/1 prot, datë 22.02.2017, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, ka nisur verifikimi i ligjshmërisë së procedurës së vlerësimit të rezultateve në punë për periudhën Korrik – Dhjetor 2016, për punonjësen *****, “Përgjegjëse në Sektorin e Koordinimit dhe Mbështetjes së Laboratorëve, në Drejtorinë e Menaxhimit të Riskut dhe Koordinimit të Inspektimit, në Autoritetin Kombëtar të Ushqimit në Nivel Qendror”.

Në zbatim të urdhrit të mësipërm, nëpërmjet shkresës nr. 65/2, datë 22.02.2017, “Njoftim mbi fillimin e verifikimit”, është vënë në dijeni institucioni Autoriteti Kombëtar i Ushqimit për këtë proces, duke i kërkuar edhe dokumentacionin e nevojshëm për realizimin e tij, dokumentacion i cili deri në momentin aktual nuk është paraqitur.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të mbledhur, Komisioneri është informuar nëpërmjet shkresës nr. 2357/1 dt. 15.03.2017 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, për faktin se nëpunësja ***** i është drejtuar gjykatës me padi, e cila është regjistruar si çështje gjyqësore administrative me nr. 31104-01724-80-2017 rregj, datë 13.03.2017, me objekt të njëjtë me këtë hetim administrativ : *Konstatimin e pavlefshmërisë absolute të vlerësimeve të punës për*

periudhën 01korrik – 13nëntor 2016, si dhe periudhën 14 nëntor -31 dhjetor 2016, në nivelin “jo kënaqshëm” (4)”.

Në këto kushte, bazuar në parimin e sanksionuar në nenin 36, të ligjit nr. 8116 datë 29.3.1996 “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”, që institucionet e tjera nuk mund të shqyrtojnë çështje që po trajtohen apo janë trajtuar nga sistemi gjyqësor, vlerësohet se në këtë rast, duhet të vendoset përfundimi i procedimit administrativ të nisur.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, si dhe nenin 34 të Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Përfundimin e procedimit administrativ të filluar me Urdhrin e verifikimit nr. 65/1 prot, datë 22.02.2017, “Për verifikimin e informacionit të ardhur nga nëpunësja *****”, “Përgjegjëse në Sektorin e Koordinimit dhe Mbështetjes së Laboratorëve, në Drejtorinë e Menaxhimit të Riskut dhe Koordinimit të Inspektimit, në Autoritetin Kombëtar të Ushqimit në Nivel Qendror”.
2. Të njoftohen për këtë vendim, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, Departamenti i Administratës Publike si dhe kërkuesja, *****.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera STRAKOSHA